

# Shkarkohet nga detyra prokurori i Apelit Tiranë, Dritan Peka



Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka shkarkuar nga detyra prokurorin e Apelit Tiranë, Dritan Peka.

Vendimi u mor të enjtën nga trupa e KPA-së.

Në korrik 2020 KPA vendosi të hetojë nga e para Pekën në të trija kriteret; pasurinë, figurën dhe profesionalitetin. Ky vendim erdhi pasi Komisioneri Publik ankimoi vendimin të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që konfirmonte Pekën në detyrë.

Komisioneri Publik argumentoi se vendimi i KPK-së kishte probleme përse i përket hetimit ndaj prokurorit Peka dhe KPA duhej të vendoste shkarkimin e tij për deklaram të pamjaftueshëm dhe për cënim të besimit të publikut te drejtësia.

Komisioneri po ashtu paraqiti disa denoncime të reja dhe kërkoi hetimin e tyre dhe një analizë të re financiare nga Kolegji. KP pretendoi se Peka rezultonte me bilanc negativ në disa vite.

Më 4 mars, KPK konfirmoi në detyrë kryeprokurorin e Apelit Tiranë, Dritan Peka, pavarësisht problemeve me pasurinë.

Me 22 prill Komisioneri Publik Darjel Sina apeloj në KPA, vendimin e KPK-së dhe kërkoi shkarkimin e tij.